



RAPORTI I MBIKËQYRJES | **2024**
SUPERVISION REPORT

TREGU I SIGURIMEVE, I FONDEVE TË PENSIONEVE PRIVATE, I FONDEVE TË INVESTIMEVE
INSURANCE, PRIVATE PENSIONS FUNDS, INVESTMENTS FUNDS MARKET

PËRMBAJTJA

I.	Misioni i Mbikëqyrjes	5
II.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve	6
	1. Struktura e Tregut të Sigurimeve	6
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	6
	3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve	8
III.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Pensionit Privat	10
	1. Struktura e tregut të Fondeve të Pensionit Privat	10
	2. Mbikëqyrja e tregut të Fondeve të Pensionit Privat	10
	3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Tregut të Fondeve të Pensionit Privat	11
IV.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve	11
	1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve	11
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve	12
	3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Fondeve të Investimeve	12
V.	Tregu i Kapitaleve	13
	1. Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Private)	14
	2. Tregu i Rregulluar	16
	3. Zhvillime në Përmirësimin e Infrastrukturës së Tregut	17
	4. Mbikëqyrja e Tregjeve të Kapitaleve	17
VI.	Aneksë	19
	A. Tregu i Sigurimeve, 31.12.2024	19
	B. Tregu i Fondeve të Pensionit Privat, 31.12.2024	81
	C. Tregu i Fondeve të Investimeve, 31.12.2024	89
	D. Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	111





TABLE OF CONTENTS

I.	Supervision Mission	5
II.	Report on the Financial Position of the Insurance Market	6
	1. Insurance Market Structure	6
	2. Insurance Market Supervision	6
	3. Analysis of Insurance Market Performance and Risks	8
III.	Report on the Financial Position of the Private Pension Fund Market	10
	1. Private Pensions Market Structure	10
	2. Private Pension Market Supervision	10
	3. Financial and technical indicators of the Private Pension Fund Market	11
IV.	Report on the Financial Position of the Investment Fund Market	11
	1. Collective Investment Undertakings Market Structure	11
	2. Investment Funds Market Supervision	12
	3. Key Indicators of the Investment Funds Market	12
V.	Capital Market	13
	1. Corporate Bonds Market (Bonds Issued via Private Placements)	14
	2. Regulated Market	16
	3. Market Infrastructure Improvements	17
	4. Capital market supervision	17
VI.	Annexes	19
	A. Insurance Market, 31.12.2024	19
	B. Private Pension Funds Market, 31.12.2024	81
	C. Investment Funds Market, 31.12.2024	89
	D. Pension Funds' and Collective Investment Undertakings' Management Companies	111



I. Misioni i Mbikëqyrjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut të sigurimeve, të titujve, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të pensioneve private në Shqipëri. AMF i ushtron funksionet mbikëqyrëse mbështetur në Ligjin nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Objektivi parësor i Autoritetit është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Në ushtrimin e veprimtarisë rregullative dhe mbikëqyrëse, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

Në përmbushje të veprimtarisë mbikëqyrëse, AMF në vazhdimësi ka përmirësuar kuadrin rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane. Mbikëqyrja realizohet nëpërmjet bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit drejt mbikëqyrjes me bazë rreziku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, si dhe rritjes së kapaciteteve për një mbikëqyrje efektive.

I. Supervision Mission

The Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) represents the integrated supervisory and regulatory authority for the insurance market, securities, collective investment undertakings, and private pension in Albania. AFSA conducts its supervisory functions pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006 “On Financial Supervisory AFSA”, as amended by Law No. 54/2014.

AFSA’s main mission is to ensure effective performance of the non-bank financial markets under supervision, as well as maintain their stability, promotion, and sound development. AFSA’s main priority is the protection of consumers and investors interests. While performing the regulatory and supervisory activities, AFSA is guided by the principles and norms of independence, transparency, and integrity.

In fulfilment of the supervisory activity, AFSA has continuously improved the supervisory regulatory framework in compliance with the international principles and European directives. Supervision is carried out through the coordination of financial documentation analysis and on-site supervision of the market, the orientation towards risk-based supervision, the undertaking of development policies for the market, as well as the increase of capacities for an effective supervision.

II. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve

1. Struktura e tregut të sigurimeve

Gjatë vitit 2024, në tregun e sigurimeve ishin të licencuara gjithsej 13 shoqëri sigurimi, nga të cilat 12 ishin aktive dhe operonin në treg. Shoqëria e 13-të mori licencën në dhjetor 2024, për të ushtruar aktivitetin në fushën e sigurimeve të Jetës dhe ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2025. Kjo hyrje e re në treg pritet të pasurojë më tej ofertën e produkteve të sigurimit dhe të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës është gjithashtu e licensuar për të ushtruar edhe aktivitetin e risigurimit. Duke ruajtur të njëjtën tendencë si në vitet e kaluara, bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë vitit 2024 vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga produktet e sigurimeve të detyrueshme dhe në veçanti nga portofoli i MTPL-së së brendshme.

2. Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve

Në tërësi, tregu i sigurimeve u paraqit i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar, me tregues të mirë likuiditeti, të aftësisë paguese si edhe të mbulimit me provigjone teknike.

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve arriti në rreth 57.03 miliardë lekë, dhe në raport me PBB-në rezultoi të jetë 2.26% në 31.12.2024. Rreth 88.6% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 11.4% i përkasin shoqërive të tregut të Jetës.

Në 31.12.2024 investimet, të cilat rezultojnë me vlerë 42.2 miliardë lekë, kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve të tregut të sigurimeve, duke zënë rreth 74.01% të totalit të tyre. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është 5.32 miliardë lekë ose 14.4% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve gjatë vitit 2024 u rritën me 7.01% krahasuar me një vit më parë. Dëmet e paguara bruto, përfshirë dhe dëmet objekt Fond Kompensimi, arritën në 8.66 miliardë lekë.

Autoriteti, në rolin e tij si organ mbikëqyrës dhe rregullator i tregut të sigurimeve, synon – ndër të tjera – të ruajë dhe të sigurojë qëndrueshmërinë financiare të tregjeve që mbikëqyr. Ky synim realizohet përmes zhvillimit të mbikëqyrjes së plotë të bazuar në rrezik, përmirësimit të rregullave të menaxhimit të rrezikut dhe përputhjes me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian dhe legjislationin në fuqi.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend me bazë rrezikun, tek dy nga shoqëritë e sigurimit, një

II. Report on the Financial Position of the Insurance Market

1. Insurance market structure

During 2024, a total of 13 insurance companies were licensed in the insurance market, of which 12 were active and operating. The 13th company was licensed in December 2024 to conduct Life insurance activities and commenced its operations in 2025. This new market entry is expected to further broaden the supply of insurance products and contribute to the continued development of the market. One of the Non-Life insurance companies is also licensed to carry out reinsurance activities. Following the same trend as in previous years, based on the technical account statements of Non-Life insurance companies, even in 2024, the insurance market continues to be dominated by compulsory insurance products, especially the internal MTPL portfolio.

2. Insurance market supervision

Overall, the insurance market appeared stable in terms of key financial soundness indicators, with good liquidity, solvency, and coverage with technical provisions.


Total assets of the insurance market amounted to approximately ALL 57.03 billion and, in relation to GDP, accounted for 2.26% as at 31.12.2024. About 88.6% of total assets are owned by Non-Life market companies, while 11.4% belong to Life market companies.

As at 31.12.2024, investments, amounting to ALL 42.2 billion, continued to dominate total insurance market assets, accounting for approximately 74.01% of the total. The increase in investments compared to the previous year amounted to ALL 5.32 billion, or 14.4% year-on-year.

In 2024, gross written premiums in the insurance market increased by 7.01% compared to the previous year. Gross paid claims, including claims subject to the Compensation Fund, amounted to ALL 8.66 billion.

AFSA, in its role as the supervisory and regulatory authority of the insurance market, aims, inter alia, to preserve and ensure the financial stability of the markets under its supervision. This objective is pursued through the development of full risk-based supervision, the strengthening of risk management rules, and alignment with relevant European Union directives and the applicable legislation.

During 2024, AFSA continued comprehensive on-site risk-based inspections at two insurance companies, one Life



shoqëri Jete dhe një shoqëri Jo-Jete. Inspektimet me bazë rreziku përqendrohen në vlerësimin e rreziqeve kryesore me të cilat përballen shoqëritë e sigurimeve, të cilat varen nga aktivitetet e tyre të biznesit. Këto inspektime shqyrtojnë gjithashtu mënyrat e administrimit dhe zbutjes së këtyre rreziqeve nga drejtuesit e lartë të shoqërisë. Vlerësohen përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit, duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së shëndetit financiar të shoqërisë.

Gjatë vitit 2024, janë realizuar pesë inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Këto inspektime janë përqendruar në aspekte që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorëve dhe verifikimin e vijueshmërisë së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Autoriteti gjatë inspektimeve të mëparshme, si dhe në përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Objekti i inspektimeve tematike për dëmet ka qenë verifikimi i procedurave dhe afateve për dëmshpërblim, veçanërisht për dëmet e sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit. Gjithashtu u vlerësua zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregullatore, si dhe i standardeve dhe procedurave operacionale për administrimin e dokumentacionit të dëmeve, në përputhje me linjën e raportimit dhe nivelin e kompetencave, me fokus te dëmet pezull dhe të paguara. U shqyrtua edhe trajtimi i ankesave për dëmshpërblim dhe saktësia e raportimit në Autoritet të provigjoneve teknike të dëmeve.

Gjithashtu, në kuadrin e inspektimeve tematike, katër prej tyre janë kryer me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit lidhur me aktivitetin e marrjes në sigurim në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore në fuqi. Gjatë inspektimeve u verifikua zbatimi i standardeve dhe procedurave operacionale të administrimit të dokumentacionit të marrjes në sigurim dhe të përgjegjësiave kontraktuale, si dhe respektimi i linjës së raportimit dhe kompetencave përkatëse. U shqyrtua saktësia e të dhënave të policave krahasuar me raportimet periodike në Autoritet, niveli i komisioneve të ndërmejtësimit për sigurimet motorike të detyrueshme në sektorin e transportit, si dhe performanca e agjentëve, brokerave dhe personelit të shitjes në të gjithë ciklin e kontratës. U verifikuan procedurat e brendshme për dizejimin e produktit dhe vendosjen e çmimeve, përputhshmëria e të dhënave të primeve në Regjistrin Elektronik të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, si dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve për informimin dhe të drejtat e tyre përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. U verifikua gjithashtu zbatimi i vendimeve të Bordit dhe rekomandimeve të mëparshme të lëna nga Autoriteti.

Në përfundim të këtyre inspektimeve, Autoriteti u komunikoi shoqërive gjetjet dhe rekomandimet përkatëse,

insurance company and one Non-Life insurance company. Risk-based inspections focus on assessing the main risks to which insurance companies are exposed, arising from their business activities. These inspections also examine the management and mitigation of such risks by the companies' senior management. The responsibilities of the Supervisory Board and senior management of insurance companies are assessed, taking into account the importance of maintaining the financial soundness of the companies.

During 2024, five thematic inspections were conducted at Non-Life insurance companies. These inspections focused on aspects directly related to consumer protection and the verification of the continued implementation of recommendations issued by AFSA during previous inspections, as well as compliance with the applicable legal and regulatory framework.

The objective of thematic inspections related to claims was to verify procedures and timelines for compensation, in particular for compulsory motor insurance claims, and to assess the implementation of recommendations arising from decisions of the AFSA Board. In addition, compliance with legal and regulatory requirements, standards, and operational procedures for the management of claims documentation was assessed, in accordance with reporting lines and levels of competence, with a focus on outstanding and paid claims. The handling of compensation complaints and the accuracy of the reporting of technical provisions for claims to AFSA were also examined.

Furthermore, within the framework of thematic inspections, four inspections were carried out with the objective of assessing insurance companies' underwriting activities in compliance with the applicable legal and regulatory obligations. During these inspections, the implementation of standards and operational procedures for the management of underwriting documentation and contractual responsibilities was verified, as well as compliance with reporting lines and respective competences. The accuracy of policy data compared to periodic reporting to AFSA was reviewed, together with the level of intermediation commissions for compulsory motor insurance in the transport sector, and the performance of agents, brokers, and sales staff throughout the entire contract cycle. Internal procedures for product design and pricing were verified, as was the consistency of premium data recorded in the Electronic Register of Compulsory Motor Insurance Sales, and the handling of consumer complaints regarding information and rights throughout the duration of the contract. The implementation of AFSA Board decisions and previous recommendations was also verified.

At the end of these inspections, AFSA communicated the relevant findings and recommendations to the insurance

si dhe adresoi me Vendime Bordi problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për t'u ndërmarrë nga shoqëritë e sigurimeve. Zbatueshmëria e rekomandimeve është në vëmendje të Autoritetit si për respektimin e afateve, ashtu edhe për detyrat e lëna.

Risigurimi është forma kryesore e transferimit të rrezikut, në industrinë e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe stabilitetin e këtij tregu. Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore, të miratuara nga Autoriteti, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të risigurojnë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguar që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet risigurimit zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve të mëdha, përmirësojnë kërkesat për kapital (aftësi pagueuse), rrisin mundësinë për të siguar më shumë rreziqe, si dhe marrin asistencë teknike dhe financiare nga shoqëritë risiguroese. Aktiviteti i risigurimit është i konsoliduar, ndikuar edhe nga kërkesat e përcaktuara në Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015, "Për kriteret e risigurimit", e ndryshuar.

Në bazë të kërkesave ligjore dhe rregullatore, shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet programin vjetor të risigurimit. Bazuar në funksionin e tij mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave të lidhura, duke synuar stabilitetin e vazhdueshëm financiar, në lidhje me mbajtjen e rrezikut të sigurimit si dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risiguroesve.

Marrëveshjet e risigurimit, në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës, janë të formës joproporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe *Quota Share*.

3. Analiza e ecurisë të tregut të sigurimeve¹

Ecuria e treguesve kryesorë financiarë të tregut të sigurimeve për vitin 2024, paraqitet si më poshtë:

- **Totali i primeve të shkruara bruto**, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në 31.12.2024 është 24.5 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 1.60 miliardë lekë ose 7.01% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto në masën 1.4 miliard lekë ose rreth 6.6% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës dhe rritje prej 210 milionë lekë ose rreth 11.3% në tregun e sigurimeve të Jetës.

¹ Treguesit financiarë pasqyrojnë të dhënat pas certifikimit të raporteve të audituara dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit.

companies and addressed the identified issues and necessary measures to be undertaken through Board Decisions. The implementation of recommendations is under the attention of AFSA, both with regard to compliance with deadlines and the fulfilment of assigned tasks.

Reinsurance is the main form of risk transfer in the insurance industry in the Republic of Albania and plays an important role in the development and stability of this market. Based on the legal framework and regulatory acts adopted by AFSA, insurance companies are required to reinsure, with a reinsurance company, that portion of insured risk exceeding the permitted limit of 10% of the capital value. Through reinsurance, insurance companies reduce exposure to major risks, improve capital requirements (solvency), increase their capacity to insure additional risks, and receive technical and financial assistance from reinsurance companies. Reinsurance activity is well consolidated, further influenced by the requirements set out in Regulation No. 85/1, dated 30.09.2015, "On reinsurance criteria," as amended.

Pursuant to legal and regulatory requirements, insurance companies report their annual reinsurance programme to AFSA. Based on its supervisory function, AFSA monitors the implementation of this programme and the related contracts, with the aim of ensuring continued financial stability, particularly with regard to insurance risk retention and criteria related to the quality of reinsurers.


Reinsurance agreements in Non-Life insurance portfolios are of a non-proportional form, mainly *Excess of Loss*, and of a proportional form, *Quota Share/Surplus*. In Life insurance, reinsurance coverage is provided through proportional reinsurance agreements of the *Surplus* and *Quota Share* type.

3. Analysis of the insurance market performance¹

The progress of the key financial indicators of the insurance market for 2024 is presented as follows:

- **The total gross written premiums** for the life and non-life insurance market as at 31.12.2024 amounted to all 24.5 Billion, marking an increase of all 1.60 Billion, or 7.01%, compared to the previous year. This increase resulted from the growth in gross written premiums of all 1.4 Billion, or approximately 6.6%, in the non-life insurance market, and an increase of all 210 million, or approximately 11.3%, in the life insurance market.

¹ Financial indicators reflect data after the certification of audited reports and the financial analysis of insurance companies.



- **Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit** për tregun e Jo-Jetës në 31.12.2024 është i mjaftueshëm, me 6.9 miliardë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 249.4%. Për tregun e Jetës treguesi është sërish i mjaftueshëm me rreth 861.3 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 146.6%.
- **Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike** për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës është 126.5%, dhe paraqitet me ulje krahasuar me 150% në fund të vitit 2023. Për tregun e Jetës ky tregues është 127.7%, dhe paraqitet me ulje krahasuar me 129.6% që ishte në fund të vitit 2023.
- **Totali i aktivitet të tregut të sigurimit** për periudhën 31.12.2024, sipas pasqyrave financiare, është rreth 57 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 6.4 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2023. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” në të dy sektorët, Jo-Jetës dhe Jetës.
- **Rezultati financiar neto** i tregut të sigurimeve për vitin 2024 është pozitiv në vlerën 2.3 miliardë lekë. Rezultati financiar në fund të vitit 2024 për shoqëritë e sigurimit ka pësuar rënie me rreth 491.9 milionë lekë, krahasuar me vitin 2023. Rezultati financiar në tregun e Jo-Jetës për vitin 2024 është ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat janë në nivelin 22.4 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet operative kanë një rritje prej 1.03 miliardë lekë krahasuar me vitin e kaluar, gjë që ka ndikuar edhe në uljen e rezultatit financiar. Ecuri pozitive kanë patur dhe të ardhurat nga investimet, të cilat kanë rezultuar në vlerën 950.4 milionë lekë, ndikuar kryesisht nga rritja e normave të interesit, dividendët etj. Gjithashtu edhe në tregun e Jetës rezultati financiar është ndikuar nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 2.1 miliardë lekë, por si efekt i rritjes së shpenzimeve operative, rezultati financiar krahasuar me vitin 2023 është ulur.
- *The capital adequacy indicator for the non-life insurance market as at 31.12.2024 Is sufficient, standing at all 6.9 Billion above the required level, or 249.4%. For the life insurance market, the indicator is also sufficient, at approximately all 861.3 Million above the required level, or 146.6%.*
- *The assets covering technical provisions indicator for the non-life insurance market stands at 126.5%, Reflecting a decrease compared to 150% at the end of 2023. For the life insurance market, this indicator is 127.7%, Also showing a decrease compared to 129.6% At the end of 2023.*
- *Total assets of the insurance market as at 31.12.2024, Based on the financial statements, amounted to approximately all 57 billion, recording an increase of all 6.4 Billion compared to 31.12.2023. This increase is mainly due to the growth of the item “investments in land, buildings, and financial investments” in both the non-life and life sectors.*
- *The net financial result of the insurance market for 2024 is positive, amounting to all 2.3 Billion. By the end of 2024, the financial result of insurance companies decreased by approximately all 491.9 Million compared to 2023. The financial result in the non-life insurance market for 2024 was mainly influenced by the increase in gross written premiums, which amounted to all 22.4 Billion, while operating expenses increased by all 1.03 Billion compared to the previous year, contributing to the decrease in the financial result. Investment income also showed a positive performance, amounting to all 950.4 Million, mainly influenced by higher interest rates, dividends, and other factors. In the life insurance market, the financial result was likewise influenced by the increase in gross written premiums, which amounted to all 2.1 Billion; however, as a result of higher operating expenses, the financial result decreased compared to 2023.*

Edhe gjatë vitit 2024, me qëllim vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, janë përdorur testet e paralajmërimit të hershëm (*Early Warning Test*). Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit të problemeve që mund të bëhen shkak për përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së AMF-së. Veprimet e Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim, përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato aktivitete, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo që mund të sjellin cenim të interesave të konsumatorëve.

During 2024, with the aim of assessing the financial soundness of non-life insurance companies, Early Warning Tests continued to be applied. These financial indicators serve to identify issues that may cause the deterioration of one or more parameters of market operators. Maintaining the sustainability of the supervised financial markets and consumer protection are among the main objectives of afsa's activity. Actions undertaken by AFSA to prevent and eliminate violations in this regard include continuous monitoring of market practices and intervention with particular emphasis on activities exposed to high risk or that may prejudice consumer interests.

Gjatë vitit 2024, rekomandimet e Autoritetit për tregun e sigurimeve lidhen kryesisht me:

- Ruajtjen e aftësisë paguese të disa shoqërive, sipas dispozitave të nenit 80 të Ligjit 52/2014;
- Ruajtjen dhe arritjen e treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, sipas dispozitave të nenit 96 të Ligjit 52/2014;
- Plotësimin e kërkesave të Bordit të AMF-së në lidhje me pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe shlyerjen e detyrimeve që lidhen me dëmet e Fondit të Kompensimit;
- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve, si edhe zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të provigjonimit të dëmeve në proces gjyqësor, për një pasqyrim sa më të drejtë të nivelit të rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë;
- Ndjekjen dhe zbatimin e rregulloreve të miratuara nga Autoriteti lidhur me trajtimin dhe pagesën e dëmeve;
- Ndalimin e ushtrimit të aktivitetit dhe pagesës së komisioneve të ndërmjetësimit me ndërmjetës të pa licencuar.
- Respektimin e kufijve të përcaktuar për komisionet e ndërmjetësimit në shitjen e produkteve të sigurimit të detyrueshëm.
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi; etj.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i Garancisë është investuar në “depozita qëllimore” në bankat tregtare dhe letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

III. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Pensionit Privat

1. Struktura e tregut të Fondeve të Pensionit Privat

Struktura e tregut të fondeve të pensionit privat për vitin 2024 përbëhet nga gjashtë fonde pensioni, të cilat administrohen nga katër shoqëri të ndryshme administruese si Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a dhe Albsig Invest

During 2024, afsa's recommendations for the insurance market mainly related to:


- Attainment and preservation of the solvency of certain companies, in accordance with the provisions of article 80 of law no. 52/2014;
- Attainment and preservation of the assets covering technical provisions indicator, in accordance with the provisions of article 96 of law no. 52/2014;
- Fulfillment of afsa board requirements regarding accurate reflection in the financial statements and the settlement of obligations related to compensation fund claims;
- Management of risks contracted by insurance companies in compliance with the applicable legal requirements;
- Evaluation and handling of claims, as well as compliance with legal requirements concerning the provisioning of claims under court proceedings, for a fair reflection of the level of risk contracted by companies;
- Follow-up and implementation of regulations approved by afsa concerning claims treatment and payment;
- Prohibition of conducting activities and paying intermediation commissions to unlicensed intermediaries;
- Compliance with the limits established for intermediation commissions in the sale of compulsory insurance products; and
- Reporting to AFSA the information required in accordance with the applicable legal requirements, among others.

AFSA has continuously followed the fulfillment of the legal requirement concerning the guarantee fund of insurance companies and the implementation of the rules governing its investment. The guarantee fund is invested in “special purpose deposits” in commercial banks and in securities issued by the Bank of Albania, in compliance with the applicable legal requirements.

III. Report on the Financial Position of the Private Pension Funds Market

1. Private Pension Fund Market Structure

The structure of the private pension fund market for 2024 consists of six pension funds, which are managed by four different managing companies, namely Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a., and Albsig Invest sh.a. The function of the depository



sh.a. Funksionin e depozitarit për fondet e pensionit e kryejnë First Investment Bank sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a, Tirana Bank sh.a dhe Banka Kombëtare Tregtare sh.a.

2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Privat

Mbikëqyrja e tregut të fondeve të pensionit privat ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me Ligjin 54/2014, Ligjin nr.76/2023 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Treguesit teknikë e financiarë të Tregut të Fondeve të Pensionit Privat

Tregu i fondeve të pensionit privat shfaqet më modest në krahasim me dy tregjet e tjera. Gjatë vitit 2024, në tregun e fondeve të pensionit privat ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde pensioni. Ky treg ka patur tendencë në rritje, e shprehur kjo në rritjen e vlerës neto të aktiveve dhe numrit të anëtarëve.

Në fund të vitit 2024, totali i aktiveve neto të fondeve të pensionit privat arriti në 8.11 miliardë lekë me një rritje prej 20.33% dhe numri i anëtarëve arriti në 44,263 me një rritje prej 15.93% në krahasim me fundin e vitit 2023.

Gjatë vitit 2024, investimet e tregut të fondeve të pensionit privat janë kryer në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Vlera e investimeve të këtij tregu në 31.12.2024 është 7.86 miliardë lekë, duke zënë një peshë prej 96.75% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit. Krahasuar me 31.12.2023 këto investime janë rritur me 21.31%. Gjatë vitit 2024, investimet e tregut të fondeve të pensionit përbëhen nga obligacione të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 5, 7, 10 dhe 15 vjeçar. Investimet në obligacione të qeverisë së RSH me afat maturimi 10 vjeçar zënë peshën më të madhe dhe përbëjnë 51.19% të totalit të investimeve të këtij tregu.

Shoqëritë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen Invest sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a, Credins Invest sh.a dhe Albsig Invest sh.a e publikojnë dhe e përditësojnë vlerën neto të aktiveve dhe vlerën neto të aktiveve për kuotë të fondit të pensionit sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

for pension funds is performed by First Investment Bank sh.a., American Bank of Investments sh.a., Tirana Bank sh.a., and Banka Kombëtare Tregtare sh.a.

2. Private Pension Funds Market Supervision

The supervision of the private pension funds market is carried out by the Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) based on Law No. 9572, dated 03.07.2006, “On the Financial Supervisory Authority,” as amended by Law No. 54/2014, Law No. 76/2023, and the related secondary legislation adopted for its implementation.

3. Financial and technical indicators of the Private Pension Fund Market

The private pension fund market appears more modest compared to the other two markets. During 2024, six pension funds exercised their activity in the private pension fund market. This market has experienced an upward trend, reflected in an increase in the net asset value and the number of members.

At the end of 2024, the total net assets of private pension funds amounted to ALL 8.11 billion, marking an increase of 20.33%, while the number of members reached 44,263, with an increase of 15.93% compared to the end of 2023.

During 2024, private pension fund market investments were performed in accordance with the applicable legal basis. The investment value of this market as at 31.12.2024 is ALL 7.86 billion, accounting for a share of 96.75% of the total assets of the private pension fund market. Compared to 31.12.2023, these investments increased by 21.31%. During 2024, investments in the private pension fund market consisted of Treasury Bonds of the Republic of Albania with maturities of 5, 7, 10, and 15 years. Investments in Government of Albania bonds with a 10-year maturity occupy the largest share and constitute 51.19% of the total investments of this market.

The pension fund managing companies Raiffeisen Invest sh.a., Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a., and Albsig Invest sh.a. publish and update the net asset value and the net asset value per unit of the pension fund in accordance with the applicable legal and regulatory provisions.

IV. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve

1. Struktura e tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Gjatë vitit 2024, në tregun e SIK ushtruan aktivitetin e tyre 16 fonde investimi nga të cilat 13 me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dhe 3 fonde alternative. Fondet e investimit janë administruar nga gjashtë shoqëri administruese, katër nga të cilat kryejnë veprimtarinë e administrimit për SIK dhe për fondet e pensionit privat, ndërkohë që dy shoqëritë e tjera kryejnë veprimtarinë e administrimit vetëm për SIK.

2. Mbikëqyrja e tregut të fondeve të investimeve

Mbikëqyrja e tregut të fondeve të investimit gjatë vitit 2024 është ushtruar nga AMF mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, Ligjin 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Tregu i fondeve të investimit, i cili përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri, ka treguar qëndrueshmëri gjatë vitit 2024 dhe ka shfaqur tendencë në rritje, krahasuar me një vit më parë. Qëndrueshmëria dhe tendenca në rritje e këtij tregu u konstatua si në nivel aktivesh në tregun e fondeve të investimeve, ashtu edhe në nivelin e flukseve neto pozitive, kthimit nga investimi për investitorët dhe numrin e investitorëve.

Në tregun e SIK, gjatë vitit 2024, ka pasur zhvillime pozitive shoqëruar me fillimin e aktivitetit në treg të dy fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, një prej të cilëve është fond investimi i qëndrueshëm, fond furnizues i fondit kryesor të administruar nga shoqëri administruese e licencuar në BE.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë regjistruar edhe dy fonde investimi alternativë për investitorë profesionistë e të kualifikuar me pjesëmarrje të hapur.

Gjatë këtij viti, filluan aktivitetin e marketimit dhe shitjes në Shqipëri gjashtë nën fonde të njohura të dy sipërmarrjeve të sipërpërmendura me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të licencuara në BE dhe të njohura nga Autoriteti duke ofruar risi për tregun shqiptar për shkak të karakteristikave ESG (mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative) që mbartin këto fonde.

IV. Report on the Financial Position of the Investment Funds Market

1. Collective Investment Undertakings (CIUs) Market Structure

During 2024, 16 investment funds exercised their activity in the CIU market, of which 13 open-ended investment funds with public offering and 3 alternative investment funds. Investment funds are managed by six managing companies, four of which perform management activities for both CIUs and private pension funds, whereas the other two companies perform management activities only for CIUs.

2. Investment Funds Market Supervision


The supervision of the investment funds market during 2024 is exercised by the Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006, "On the Financial Supervisory Authority," as amended, Law No. 56/2020, "On Collective Investment Undertakings," and the related secondary legislation.

The investment funds market, which represents a significant part of the financial sector in Albania, demonstrated stability during 2024 and showed an upward trend compared to the previous year. This stability and upward trend were observed both in the level of assets in the investment funds market and in net positive flows, returns on investment for investors, and the number of investors.

In the investment funds market, positive developments were recorded during 2024, accompanied by the commencement of activity of two open-ended investment funds with public offering, one of which is a sustainable feeder fund of a master fund managed by an EU-licensed management company.

In addition, during 2024, two open-ended alternative investment funds for professional and qualified investors were registered.

During 2024, marketing and sales activities in Albania also commenced for six recognised sub-funds of the two above-mentioned EU-licensed undertakings for collective investment in transferable securities (UCITS), recognised by AFSA, introducing innovations to the Albanian market due to the ESG (environmental, social, and corporate governance) characteristics of these funds.



3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive më 31.12.2024

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK) vijon të përfaqësojë një pjesë të rëndësishme të tregjeve nën mbikëqyrje. Gjatë vitit 2024, ky treg ka treguar qëndrueshmëri dhe ka shfaqur tendencë në rritje krahasuar me një vit më parë.

Totali i aktiveve neto të tregut të SIK për periudhën 31.12.2024 arriti në rreth 61.36 miliardë lekë, me një rritje 22.02% krahasuar me vitin 2023, ndikuar kryesisht nga rritja në aktivet neto të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Për të njëjtën periudhë, totali i aktiveve neto të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është në vlerën rreth 55.38 miliardë lekë me një rritje prej 21.83%, krahasuar me fundvitin 2023. Totali i aktiveve neto të fondeve të investimeve alternative në 31.12.2024 është në vlerën 5.98 miliardë lekë me një rritje prej 23.84% krahasuar me fundvitin 2023.

Numri i investitorëve për 31.12.2024 në tregun e fondeve të investimit është 37,786, ku përfshihen edhe 7 investitorë të fondeve të investimeve alternative. Numri i investitorëve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 37,779 duke shënuar një rritje prej 17.40% gjatë këtij viti.

Tregu i fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë 79.24% të aktiveve të këtij tregu.

AMF ka monitoruar edhe treguesin e likuiditetit si dhe asetet në të cilat mbahet rezerva e likuiditetit për fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike.

V. Tregu i Kapitaleve

Krahas aktivizimit të dy segmenteve kryesorë të tregut të kapitaleve, segmentit të titujve të qeverisë dhe të obligacioneve të emetuara me ofertë private, gjatë vitit 2024 u tregtuan vazhdimisht nga anetarët e Bursës edhe obligacionet e emetuara gjatë vitit 2023 me ofertë publike. Bankat kanë zgjeruar aktivitetin e tyre, duke i ofruar klientëve mundësi investimi në një gamë të gjerë instrumentesh financiare të huaja, përfshirë Eurobondin e Republikës së Shqipërisë, në funksion të diversifikimit të portofolit të investimit tyre. Në vitin 2024, vëllimi total i tregtimit në instrumente financiare të huaja, arriti në rreth 80 milionë Euro.

Gjatë vitit 2024 fokusi i Autoritetit ka vijuar të jetë nxitja e zhvillimit të tregjeve të kapitalit si alternativë financimi dhe investimi.

3. Key Indicators of the Collective Investment Undertakings Market as at 31.12.2024

The Collective Investment Undertakings (CIUs) market continues to represent a significant part of the markets under supervision. During 2024, this market demonstrated stability and showed an upward trend compared to the previous year.

The total net assets of the CIUs market as at 31.12.2024 reached approximately ALL 61.36 billion, marking an increase of 22.02% compared to 2023, mainly driven by the growth in the net assets of open-ended investment funds with public offering. Over the same period, total net assets of open-ended investment funds with public offering amounted to approximately ALL 55.38 billion, reflecting an increase of 21.83% compared to the end of 2023. Total net assets of alternative investment funds as at 31.12.2024 amounted to ALL 5.98 billion, recording an increase of 23.84% compared to the end of 2023.

As at 31.12.2024, the number of investors in the investment funds market stood at 37,786, including 7 investors in alternative investment funds. The number of investors in open-ended investment funds with public offering reached 37,779, recording an increase of 17.40% during the year.

The market for open-ended investment funds with public offering is primarily dominated by investments in Albanian government bonds and Treasury bills, which account for 79.24% of the assets of this market.

The Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) also monitored the liquidity indicator and the assets in which the liquidity reserve is held for open-ended investment funds with public offering.

V. Capital Market

Alongside the activation of the two main segments of the capital markets, the government securities segment and privately placed bonds, during 2024, bonds issued in 2023 through public offering were also traded on a continuous basis by stock exchange members. Banks further expanded their activities by offering clients investment opportunities in a wide range of foreign financial instruments, including the Eurobond of the Republic of Albania, with a view to diversifying their investment portfolios. In 2024, total trading volume in foreign financial instruments reached approximately EUR 80 million.

During 2024, the AFSA continued to focus on promoting the development of capital markets as an alternative source of financing and investment.

Tabela 1: Subjekte të Tregut të Kapitaleve

Table 1: Capital Market Entities

(Në numër)
(In numbers)

Subjekte / Entity	2020	2021	2022	2023	2024
Bursë Titujsh (Tregu i rregulluar) <i>Securities Exchange (Regulated Market)</i>	1	1	1	1	1
Shoqëri Komisionere/Banka që ofrojnë shërbime investimi / <i>Investment firms/banks that provide investment services</i>	12	13	13	11	11
Banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë të Titujve / <i>Banks that provide securities custody services</i>	9	10	10	9	9
Depozitar Qendror Titujsh/Regjistrar <i>Central Securities Depository/Registrar</i>	2	2	2	2	2
Banka që ofrojnë shërbimin e administrimit të portofolit / <i>Banks that provide portfolio management service</i>	0	0	1	1	1
Shoqëri komisionere /Banka që ofrojnë shërbimin e këshillimit dhe dhënies së rekomandimeve për investime / <i>Investment firms/banks that provide consulting services and investment recommendations</i>	1	1	1	1	1
Banka që ofrojnë shërbimin e nënshkrimit të instrumentave financiare / <i>Banks that provide the service of underwriting financial instruments</i>	0	0	2	2	2
Banka që ofrojnë shërbimin e investimit online <i>Banks that provide online investment services</i>	0	0	2	2	2
Agjent i lidhur / <i>Related Agent</i>	4	2	0	0	0
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Private <i>Private Placement Bonds Issuer</i>	7	6	8	11	12
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Publike <i>Public Placement Bonds Issuers</i>				1	1

1. Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Private)

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, është konsoliduar me rritje të konsiderueshme vit pas viti. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti në rreth 28 miliardë lekë në fund të vitit 2024, nga rreth 20 miliardë lekë në fund të vitit 2023, me një rritje prej rreth 40%.

Aktualisht në treg janë 12 emetues aktiv të obligacioneve me ofertë private, nga të cilët 7 banka, 3 institucione mikrokredie dhe 2 shoqëri tregtare. Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka regjistruar 7 akt-oferta të përgatitura nga 5 emetues (4 banka dhe 1 institucion mikrokredie). Edhe gjatë 2024 bankat kanë vijuar të jenë emetuesit më të shpeshtë për qëllim të kapitalit rregullator.

1. Corporate Bonds Market (Bonds Issued via Private Placements)

The private placement bonds market has further consolidated, recording significant year-on-year growth. The outstanding amount of this financial instrument reached approximately ALL 28 billion at the end of 2024, up from around ALL 20 billion at the end of 2023, representing an increase of approximately 40%.

There are currently 12 active private placement bond issuers on the market, including 7 banks, 3 microcredit institutions, and 2 commercial companies. During 2024, the Authority registered seven offering memoranda prepared by five issuers (4 banks and 1 microcredit institution). In 2024, banks continued to be the most frequent issuers for regulatory capital purposes.


Tabela 2: Stoku i emetimeve të obligacioneve me ofertë private
Table 2: Outstanding amount of bonds issued through private placements

Vitet / Years	Stoku i emetimeve të obligacioneve me ofertë private (Në million) Outstanding amount of bonds issued through private placements (In mln.)			
	Lekë / ALL	EUR	USD	Total
2020	3,972.00	28.09	5.74	8,025.55
2021	4,724.00	38.56	5.95	10,014.42
2022	5,615.50	67.99	6.41	14,068.19
2023	7,050.50	122.65	7.02	20,450.84
2024	9,690.50	185.16	6.21	28,449.30

Grafik: Shuma e pashlyer e obligacioneve me ofertë private

Chart: Private offering bonds outstanding amount

(Në milionë Lekë)
(In ALL million)



1.1 Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Publike)

Gjatë vitit 2024, janë tregtuar në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE, nëpërmjet anëtarve të saj për llogari të klientëve, obligacionet e emetuara nëpërmjet ofertës publike, në shumën 500 milion lekë, me afat 5 vjet, të institucionit financiar jo bankë.

1.1 Corporate Bonds Market (Bonds Issued via Public Offering)

In 2024, bonds issued through public offering, with a full amount of ALL 500 million being subscribed and a maturity of five years, by a non-bank financial institution, were traded on the Albanian Stock Exchange (ALSE) through its members on behalf of their clients.

2. Tregu i Rregulluar

Bursa Shqiptare e Titujve - ALSE

Autoriteti, në statusin e vëzhguesit të sistemit të tregtimit të Bursës Shqiptare të Titujve ndoqi në kohë reale transaksionet e Bursës në çdo seancë tregtimi. Nga monitorimi nuk rezultoi ndonjë problematikë lidhur me sjelljen e Anëtarëve në Bursë.

Që prej fillimit të aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE, në shkurt të vitit 2018, deri në dhjetor të vitit 2024 në Bursë është realizuar një vëllim tregtimi prej rreth 4.2 miliardë lekë, prej të cilave 537.9 milionë lekë i përkasin vëllimit të tregtimit të realizuar përgjatë vitit 2024.

